



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim e datës 28.11.2023 si dhe kërkesa shtesë për rishqyrtim e datës 29.11.2023 të operatorit ekonomik "International Group Base" Sh.P.K. kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "International Group Base" Sh.P.K. e datës 28.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.
- II. **HEDHET** poshtë si e palejuar - pasafatshme kërkesa shtesë për rishqyrtim e datës 29.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "International Group Base" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "International Group Base" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4576-2-1-1.

Tutje me datë 29.11.2023 parashtruesi ka paraqitur edhe një kërkesë tjetër për rishqyrtim (shtesë/plotësim) kundër njoftimit mbi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit për të cilin po bëhet fjalë.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa e parë për rishqyrtim e datës 28.11.2023 është e lejuar dhe brenda afatit ligjor mirëpo kërkesa e dytë për rishqyrtim (kërkesa shtesë/plotësuese) e parashtruar me datë 29.11.2023 është e palejuar për arsye se është parashtruar pas afatit ligjor.

Sa i përket kërkesës së parë për rishqyrtim të datës 28.11.2023, pretendimet e parashtruesit janë formuluar në këtë mënyrë "Bazuar në LPP dhe të drejtën tonë për shqyrtimin e vendimit tuaj lidhur me Aktivitetin e Prokurimit të cilin kemi marrë pjesë dhe kemi ofertuar me ofetën më të përgjegjshme në këtë aktivitet, Ne nuk pajtohemi me pretendimet tuaja për eliminim të ofetës tonë, edhe pse në herën e parë arsyet e eliminimit kanë qenë të pabzuara të cilat edhe ju i keni konfirmuar në vendimin tuaj. Në letren Standarte të datës 23.11.2023 keni përdorur "arsye" të shpikura dhe jo të bazuara në cilin do Ligjë në fuqi janë përdorur fraza të padëgjuesha deri më tani të cilat shfaqin në formë të qartë TENDENCEN që edhe me fakte IMAGJINARE të eliminohet oferta jonë".

Lidhur me pretendimet e parashtruesit sipas kërkesës së parë për rishqyrtim, fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk ka arritur të prezantoj asnjë pretendim konkret kundër njoftimit mbi vendimit apo vendimeve të aktivitetit të prokurimit. Parashtruesi thjeshtë thotë se nuk pajtohet me arsyet për eliminimin e tij pasi që sipas tij këto arye janë të shpikura dhe imagjinare. Pra fakti që ai nuk pajtohet me arsyet për eliminimin nuk përbën pretendim në vetvete. Pretendimi duhet të jetë i formuluar saktë dhe në mënyrë konkrete në përputhje me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP ku përcaktohet se "Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit". Sidoqoftë duhet shtuar se arsyet për eliminimin e tij nuk janë aspak imagjinare dhe të shpikura sikurse aludon parashtruesi, por janë të sakta, të konfirmuara dhe të evidentuara sikurse në raportin e vlerësimit nga komisioni objektiv dhe profesional ashtu edhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Sidoqoftë, parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim nuk ka arritur të formuloj pretendime konkrete ankimore sikurse përcaktohet me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP. Në këtë drejtim, përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se "Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore". Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa e parë për rishqyrtim e datës 28.11.2023 duhet të refuzohet si e pabazuar në tërësi duke u bazuar në nenin 62 par. 62.1 nënparagrafit b) lidhur me nenin 59 par. 59.1 të RRPP.

Sa i përket kërkesës së dytë për rishqyrtim të datës 29.11.2023, përmes nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit c) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet sipas afatit vijues "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK është dita (0)". Në rastin konkret data njoftimit mbi vendimin është 23.11.2023 dhe kjo kalkulohet si dita zero. Kërkesa e dytë për rishqyrtim (shtesë/plotësuese) është parashtruar me datë 29.11.2023 që nënkupton se është parashtruar në ditën e gjashtë me rradhë pas ditës zero, që nënkupton se kërkesa është paraqitur me një (1) ditë vonesë. Si e tillë kërkesa e dytë për rishqyrtim është e palejuar për shkak se është e pasafatshme në kuptim të nenit 60 par. 60.1. nënpar. c) të RRPP.

Dërguar nga : INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.	
Kërkesë për rishqyrtim	
Kërkesë për rishqyrtim - Kërkes për RI-SHQYRTIM	
Kodi i dokumentit:	
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>
Dokumenti Shtojca	
<u>29.11.2023 13:08</u>	Plotësimi i kërkeses per rishqyrtim KPSH-KPR.docx
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>

Vlen të shtohet se titulli me të cilin është ngarkuar për rishqyrtim është "plotësim i kërkesës për rishqyrtim". Megjithatë fakti kryesor në këtë rast është se dokumenti është ngarkuar pas afatit përkatës me datë 29.11.2023. Prandaj ajo trajtohet si kërkesë e re për rishqyrtim (dokumenti i ri) dhe trajtohet në përputhje të plotë me RRPP dhe LPP. Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 të RRP përcaktohet se "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj RRPP". Tutje përmes nenit 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) përcaktohet se "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me anë të një vendimi, mund të refuzojë kërkesën për shqyrtim sipas Nenit 62 të kësaj rregullore kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit".

Sa i përket kërkesës së parë për rishqyrtim të datës 28.11.2023, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa e parë për rishqyrtim e parashtruesit e datës 28.11.2023 është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Sa i përket kërkesës së dytë për rishqyrtim të datës 29.11.2023, është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin c) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.12.2023


Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.